



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 54 Prot.

Tiranë, më 08.01.2025

V E N D I M

Nr. 12, Datë 08.01.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr.152 Regj., datë 22.07.2024, paraqitur nga z. S. F., në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve Durrës-Hamallaj, me operator të licencuar Shoqëria “R. T.”, sh.p.k, me NIPT nr. L42313502B.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *Më datë 04.07.2024, në orën 13:00, mora autobusin nga Durrësi për në Hamallaj. Në autobus nuk kishte faturino, dhe në momentin e zbritjes së pasagjerëve pagesa për udhëtimin bëhej te shoferi. Të njëjtin veprim bëra dhe unë, ku së bashku me lekët i tregova librezën e verbërisë. Shoferi, në mënyrë fyese, më tha që autobuzi ishte privat dhe se ai e kishte blerë, duke e justifikuar se ishte në rregull me dokumentacionin e qarkullimit dhe se askush nuk mund ta detyronte të merrte gjysmën e vlerës për biletën (50 lekë). Ai gjithashtu tha se kishte 30 vite në këtë linjë dhe se askush nuk kishte paguar 50% të vlerës së biletës, sepse nuk e njihte këtë ligj (këtë të drejtë që i takon).*

Në situatën e mësipërme, Shoqata Shpresë për të Verbërit i është drejtuar me një shkresë Bashkisë Durrës, duke kërkuar që të detyrojë linjat e transportit që licencohen prej saj të

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

zbatojnë ligjin për personat me aftësi të kufizuara, për të përfutuar nga ky shërbim që u ofron ligji.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave për shkak të tij.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, apo në raport me të drejtat e tyre ligjore.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “*1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfitur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në kushtet kur, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Durrës-Hamallaj, me të cilën kishin udhëtuar në datën 04.07.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 1074/1, datë 25.07.2024, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Bashkisë Durrës.

Me shkresën nr.9094/1, datë 13.08.2024², Bashkia Durrës, përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: *Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 471, datë 23.12.2017, “Për miratimin e linjave rrethqytetase të transportit publik në territorin e Bashkisë Durrës, itinerarin, stacionet dhe oraret e tyre”, i ndryshuar me VKB nr. 489, datë 23.04.2018, VKB nr. 508, datë 30.05.2028 dhe VKB nr. 53, datë 20.04.2021, janë miratuar linjat rrethqytetase të transportit publik për territorin e Bashkisë Durrës, si dhe itinerarin, stacionet dhe oraret e tyre.*

Subjekti “R. T.” sh.p.k., me NIPT L42313502B, është i licencuar nga Bashkia Durrës me Licencën nr. 4, datë 26.02.2018, për kryerjen e shërbimit të transportit të udhëtarëve për linjën rrethqytetase: Linja 6, me itinerarin Durrës-Hamalla-Durrës.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

² Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1074/3, datë 14.08.2024.

Me shkresën nr. 1074/4, datë 15.08.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet për ankesën e bërë, si dhe ka kërkuar aktet e mëposhtme:

- Informacion nga ana e Shoqërisë “R. T.,” sh.p.k., lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion nëse Shoqëria “R. T.,” sh.p.k. ofron transport për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht për personat e verbër, bazuar në lehtësirat të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.
- Masat që ka marrë vetë Shoqëria në lidhje me zbatimin e pikave të Licencës nr. 4, datë 26.02.2018, “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, sipas legjislacionit në fuqi për personat me aftësi të kufizuara, personat e verbër dhe shoqëruesit e tyre.
- Kopje të akteve të monitorimit dhe/ose kontrollit të realizuar për periudhën qershor-korrik 2024, nëse disponohen prej jush.
- Çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe që do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- A është paraqitur ndonjë ankesë pranë jush lidhur me sa më sipër? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra nga ana juaj? Parashtrime dhe kopje të akteve provuese, nëse ka.

Me shkresën nr. 9526/1 prot., datë 21.09.2024³, Bashkia Durrës ridërgoi të gjithë informacionin e kërkuar nga Komisioneri. Ajo gjithashtu informoi se ishin marrë të gjitha masat për ndërgjegjësimin dhe monitorimin e të gjitha linjave që operojnë në këtë bashki.

Duke marrë shkas nga fakti që informacioni i kërkuar nga Shoqëria “R. T” sh.p.k. nuk ishte përcjellë pranë Komisionerit, me shkresën nr. 1074/8 prot., datë 10.09.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua përsëri Shoqërisë “R. T.” sh.p.k. dhe rikërkoi informacionin e kërkuar me shkresën nr. 1074/4 prot., datë 15.08.2024.

Me shkresën nr. 10323/2 prot., datë 17.09.2024⁴, Bashkia Durrës, në vijim të ankesave të qytetarëve të ndryshëm mbi problematikat e linjës rrethqytetase Durrës-Hamallaj-Durrës, ka informuar Komisionerin se: *“Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave për personat me aftësi të kufizuara, me shkresën nr. 10323 prot., datë 09.09.2024, i është drejtuar Policisë Bashkiake Durrës për monitorimin në terren të këtyre dy linjave, lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të licencimit nga ana e dy operatorëve që ofrojnë shërbimin për transportin e personave me aftësi të kufizuara.*

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1074/6, datë 22.08.2024

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1074/9, datë 19.09.2024

Me anë të shkresës nr. 10323/1 prot., datë 16.09.2024, kemi marrë përgjigje nga Policia Bashkiake, e cila dërgon informacionin pranë nesh pas monitorimit të këtyre dy linjave në terren, të kryer nga Sektori i Qarkullimit Rrugor.

Nga monitorimi nuk janë konstatuar raste problematike. Sipas drejtuesve të mjeteve të këtyre linjave, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara nuk njihen vetëm në rastet kur këto persona gjatë udhëtimit nuk janë të pajisur me librezën e verbërisë përkatëse, të lëshuar nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Për ta, është e domosdoshme që të disponojnë dhe të tregojnë këtë librezë; në të kundërt, nuk përfitojnë shërbimin e pretenduar nga ana e tyre.”

Me shkresën nr.26 prot, datë 23.09.2024⁵, Shoqëria "R. T.", sh.p.k, ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e saj përsa i takon pretendimeve të paraqitura nga subjekti ankues, duke parashtruar ndër të tjera, se: “Në përgjigje të shkresave Tuaja 1074/1 dhe 1074/2 për ankesën e z. F., ju kërkohet ndjesë për vonesën, por e kemi vonuar përgjigjen sepse kemi hetuar rastin e pretenduar nga ankuesi dhe kemi monitoruar linjën për të arritur në një përfundim në lidhje me udhëzimet dhe orientimet që i kemi dhënë punonjësve të shoqërisë sonë për zbatimin e detyrimeve ligjore për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me situatën e pretenduar nga z. F., nuk rezulton të ketë ndodhur ndonjë situatë e pakëndshme ose të mos jetë trajtuar sipas normave dhe detyrimeve të ligjit nga punonjësit e shoqërisë në këtë linjë.

Sqarojmë se shoferët e shoqërisë dhe stafi i punëtorisë së shoferëve janë orientuar dhe janë rikujtuar herë pas here për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligjet 7889/94, të ndryshuar me nr. 7663/93, dhe ligjit 8098/96, për të shmangur rastet e ankesave dhe mosdhënien e shërbimit sipas këtyre parashikimeve.

Në të gjitha rastet, për të shmangur situata të tilla, kemi parashikuar që personave me aftësi të kufizuara t'i ofrohet ky shërbim. Kur ata paraqesin librezën e shoqatës së z. Farrici, shpesh nuk paraqesin librezën e sigurimeve, arsyen e së cilës nuk e dimë, dhe bëjnë ankesa që në shumicën e rasteve i sajojnë vetë.

Shoqëria jonë në autobusë ka vendosur numrin e administratorit për çdo shqetësim gjatë udhëtimit.

Nga ana jonë, do të vazhdojmë të zbatojmë me përpikmëri çdo detyrim që ka dhënë ligji dhe do të jemi gjithmonë bashkëpunues me Komisionerin.”

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1074/10, datë 26.09.2024

Me e-mailin e datës 30.09.2024, informacioni i dërguar me shkresën nr. 26 prot., datë 23.09.2024, nga Shoqëria "R. T.," sh.p.k., iu dërgua z. S. F., për të shprehur kundërshtimet e tij në lidhje me këtë qëndrim, por që nga ana e tij nuk u kthye përgjigje.

Bazuar në nenin 33/8 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e ankuesve, caktoi datën 18.12.2024, në orën 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 1074/12 prot., datë 02.12.2024.

Seanca dëgjimore u zhvillua vetëm me pjesëmarrjen e palës ankuese, e cila mori pjesë personalisht. Ndërkohë, pala kundër të cilës është bërë ankesa nuk u paraqit në këtë seancë dëgjimore, megjithëse, sipas Fletës së Lajmërim Marrjes, ka marrë njoftim në datën 03.12.2024.

Pala ankuese qëndroi me të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur. Po ashtu, deklaroi se në të gjitha udhëtimet e linjave të ndryshme të transportit rrugor, paraqet librezën e lëshuar nga Shoqata "Shpresa për të Verbërit", pasi në gjykimin e tij ka të njëjtën fuqi ligjore dhe duhet të përfitojë dhe gëzojë të njëjtat lehtësira ligjore.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë e të pafavorshëm të ankuesit nga ana e Shoqërisë "Rando Transport" sh.p.k.

Në ankesën e depozituar nga ana e z.S. F., pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, i verbër nga ana e Shoqërisë së transportit "R. T.,"sh.p.k, përmes mosnjohjes së të drejtës për të udhëtuar me vlerën 50% të biletës, në linjën e transportit rrethqytetas, ndërkohë që një gjë e tillë është e parashikuar në legjislacionin përkatës.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri ka analizuar dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e udhëtimit në transportin urban rrethqytetas të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar/të verbër.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi⁶ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas⁷, (2) transport rrethqytetas⁸ dhe (3) transport ndërqytetas⁹. Transporti qytetas që përbën objektin e kësaj ankese, bën pjesë në kompetencat e pushtetit vendor. Ndërkohë që, transporti rrethqytetas rregullohet

⁶ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

⁷ Transporti qytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese

⁸ Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

⁹ Transporti ndërqytetas bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin qendror dhe atë vendor.

Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitimin e transportit për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizim Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*” (Ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.03.2012). Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: “*Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.*”.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit*”. Aktualisht, ky nen parashikon: “*Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*”

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban¹⁰ falas dhe transport interurban¹¹/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Edhe legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban qytetas, për shtresat dhe kategoritë vunerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori. Për sa më sipër, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar)¹² parashikon:

¹⁰ Terminologji e përdorur në këto ligje;

¹¹ Terminologji e përdorur në këto ligje;

¹² Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”, ligjin nr. 37/2014 “*Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”, ligjin nr. 21/2013, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore*”).

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjies për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta.

Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Për sa më sipër, edhe neni 85, i ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, ka vendosur detyrimin dhe ka autorizuar nxjerrjen e një akti nënligjor nga ana e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktojë, masat, kriteret dhe procedurat për kompensimin e tarifës së transportit ndërqtetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta. Ky akt nënligjor nuk rezulton të jetë miratuar.

Në referencë të akteve nënligjore të miratuara në fushën e transportit, Komisioneri është fokusuar edhe në parashikimet e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, Pika 7, e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor” parashikon: “Për udhëtarët, që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, çmimi i biletave për transportin qytetas dhe rrethqytetas caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim, me vendim të këshillit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”. Për shërbimin ndërqtetas të transportit rrugor të udhëtarëve, rregullat e posaçme, kriteret dhe procedurat për rimbursimin e shoqërive të transportit rrugor ndërqtetas për personat që përfitojnë lehtësi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore të veçanta, caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përgjegjës për financat, për transportin rrugor, për mbrojtjen sociale dhe për arsimin.

Në referencë të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, licenca për shërbimin e rregullt në transportin qytetas/rrethqytetas të udhëtarëve, lëshohet nga Bashkia përkatëse.

Në vijim, vlen të përmendet edhe Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”. Ky udhëzim bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë. Personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me Kartat standarde të personalizuar. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës,

të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbrit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas. Subjekti është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t'i krijojë sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh. Kjo kategori është përfituese e kompesimit, i cili nuk është përcaktuar akoma në çfarë mase, si dhe nuk janë përcaktuar kriteret për përfitimin e tij, pasi nuk është miratuar ende akti nënligjor, që duhet të bëjë përcaktime të tilla.

Në vendimmarrjet e mëparshme të KMD-së¹³ lidhur me mungesën e daljes së këtij akti rregullator nënligjor/VKM, Komisioneri, ka rekomanduar që:

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”*, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e të verbërit”*, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*.

Komisioneri, vëren se, pavarësisht këtij vakumi ligjor, Shoqëria njeh dhe zbaton detyrimin e saj, përcaktuar edhe në aktet e tjera rregullatore që lidhen specifikisht me të drejtën e ushtrimit të shërbimeve që ofron kjo Shoqëri, si dhe Licencën për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetase/rrethqytetase të transportit rrugor të udhëtarëve. Detyrim ky i konfirmuar në përgjigjen zyrtare depozituar pranë KMD-së.

Shoqëria “Rando Transport”sh.p.k, në parashtimet dërguar Komisionerit, ka informuar se pranon të gjithë personat me aftësi të kufizuara që të udhëtojnë me të gjitha lehtësirat që ka parashikuar legjislacioni në fuqi, në rastet kur ato vërtetojnë/tregojnë, dokumentacionin sipas formës së kërkuar nga aktet ligjore në fuqi. (*librezën origjinale ose kopje të noterizuar të aftësisë së kufizuara të Shërbimi Social Shtetëror ose raportin mjeko ligjor të KMCAP/KMPV origjinale ose kopje e noterizuar*).

Nga ana tjetër, subjekti ankues gjatë seancës dëgjimore sqaroi dhe specifikoi se në atë udhëtim, por jo vetëm në këtë rast, ka paraqitur librezën e verbërisë të lëshuar nga Shoqata "Shpresa për të Verbërit". Po ashtu, ai deklaroi dhe pretendoi se librezën e lëshuar nga Shoqata e konsideron me të njëjtën fuqi ligjore si librezën e Shërbimit Social Shtetëror, ose si vërtetimin origjinal/noterizuar të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë. Sipas tij, në këtë rast

¹³ Vendimi nr. 67, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 146, datë 06.08.2021; Vendimi nr. 174, datë 20.09.2021, i KMD-së, etj.

konkret, i është mohuar kjo e drejtë, pra përfitimi i lehtësirave në transport, siç parashikohet nga ligji.

Edhe legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban qytetas/rrethqytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “*Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve*”, bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë.

Personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas. Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar me gjysëm bilete në transportin urban ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar)¹⁴ parashikon se:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjes për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”.

¹⁴ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*).

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se:

“3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”

10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër bëhet me 0% të tarifave për transportin urban dhe 50% të tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i të verbërit të grupit të parë”.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Bashkia Durrës në lidhje me këtë problematikë, rezulton se subjektet e licencuara nga ana e saj, për kryerjen e shërbimeve të transportit të udhëtarëve duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kriteret dhe rregullat sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin 8308, datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor” të ndryshuar dhe të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit.”

Me marrjen e Çertifikatës “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetas/rrethqytetas” nga Bashkia, mbajtësi i kësaj licence dhe certifikate ka obligimin dhe përgjegjësinë të sigurojë që të gjitha shërbimet e ofruara të përmbushin kërkesat ligjore për personat me aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë se ai duhet të krijojë kushte të përshtatshme dhe të ofrojë asistencë të nevojshme për të garantuar aksesin dhe cilësinë e shërbimeve për këtë kategori, duke u angazhuar për respektimin e të drejtave të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin ligjor specifik*.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar se cilat shkresa konsiderohen *dokument ligjor*, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kreun VIII “Shkresat” ka përcaktuar respektivisht si më poshtë citohet:

Neni 246 “Fuqia provuese e shkresave” ka parashikuar se:

“Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”.

Neni 251 “Kopja e shkresës dhe origjinale i saj”, i tij, ka parashikuar se:

“Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin”.

Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, në nenin 3/c) të tij, ka përcaktuar se:

“Noter” është personi fizik i licencuar nga ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale brenda territorit të një bashkie të caktuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Në Kreun V të këtij ligji, janë përcaktuar kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e noterit. Kështu, neni 62, pika 1/i, e tij ka parashikuar se:

*“Noteri, përveç kompetencave të parashikuara në ligje të veçanta, harton akte, kryen njësime, vërtetime dhe verifikime në të gjitha çështjet, duke përfshirë, por pa u kufizuar:
.....*

i) vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ligji ka mirëpërcaktuar se cilat shkresa konsiderohen si dokument ligjor, mënyrën e hartimit apo njësimit të tyre si dhe autoritetin përgjegjës i cili gëzon ligjërisht këto kompetenca. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues për të përfituar udhëtimin me 50% të vlerës së biletës në linjat e transportit urban rrethqytetas duhet të tregojë dokumentin ligjor përkatës dhe konkretisht librezën origjinale ose kopje të noterizuar të aftësisë së kufizuar të Shërbimi Social Shtetëror ose raportin mjeko ligjor të KMCAV/KMPV origjinale ose kopje e noterizuar.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson të drejtë kërkesën e Shoqërisë “R. T.,” sh.p.k, lidhur me detyrimin e subjekteve që disponojnë Librezë Verbërie të SHSSH, për të paraqitur dokumentin origjinal, ose fotokopjen e noterizuar të saj, si dokument të vlefshëm sipas përcaktimeve specifike ligjore, në mënyrë që të përfitojnë nga lehtësirat përkatëse për të udhëtuar në transportin urban rrethqytetas me 50% të vlerës së biletës.

Në këtë rast, z. F., dhe Shoqëria “R. T.,” sh.p.k. kanë pretendime të ndryshme për situatën. Ankuesi është shprehur se nuk është trajtuar siç duhet, ndërsa Shoqëria “R. T.,” sh.p.k. pretendon se nuk ka ndodhur një situatë e tillë, ku ankuesi të mos jetë trajtuar sipas normave dhe detyrimeve të ligjit nga punonjësit e shoqërisë në këtë linjë, ku në çdo rast, ajo ka zbatuar ligjin dhe nuk ka pasur probleme.

Përfundimisht, duke mbajtur në konsideratë:

- Paqartësitë që ekzistojnë në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, në lidhje me mënyrën e përfitimit të lehtësirave në transport nga ana e personave me aftësi të kufizuara, përfshi

personat që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Pa paragjykuar këtu detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër në momentin e pajisjes së saj me licensë;

- Sjelljen e Shoqërisë “R. T.,” sh.p.k, që angazhohet të sigurojë që të gjitha shërbimet e saj të ofrohen në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi dhe të respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- Faktin që ndaj Shoqërisë “R. T.,”sh.p.k nuk janë paraqitur ankesa të tjera të të njëjtës natyrë, pra është subjekt për herë të parë;
- Parregullsitë në dokumentacionin përkatës provues të paraqitur nga ana e ankuesit;
- Qëllimin parandalues të Komisionerit dhe jo vetëm konstatues dhe ndëshkues.

Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në faktet dhe provat që janë vënë në dispozicion nga palët, si dhe atyre të grumbulluara gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk arriti të konstatojë se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë “R. T.,” sh.p.k.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shoqëria “R. T.,” sh.p.k, nuk duhet të gjendet përgjegjëse për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2024 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar në dëm të ankuesit, z. Sajmir Farrici.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, z.S. F., në fushën e të mira dhe shërbimeve, nga ana e Shoqërisë “R. T.,” sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Rekomandohet Shoqëria “R. T.,” sh.p.k, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për mënyrën e ofrimit të udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të

kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.

3. Shoqëria “R. T.,” sh.p.k, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA